

VENDIM
Nr.293, datë 28.4.2010

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.600, DATË 12.9.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN ME STREHIM TË NËPUNËSVE CIVILË TË ADMINISTRATËS SË LARTË SHTETËRORE DHE TË FUNKSIONARËVE POLITIKË“, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 20 të ligjit nr.8550, datë 18.11.1999 “Për statusin e deputetit”, të nenit 30 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 12 të ligjit nr.8095, datë 21.3.1996 “Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 18 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”, të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.7496, datë 3.7.1991 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.600, datë 12.9.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas shkronjës “f” të pikës 1, shtohen shkronjat “g” dhe “gj”, me këtë përmbajtje:

“g) Akademikë;

gj) Personalitete të shquara në fushën e shkencës, artit, kulturës, sportit dhe fushave të tjera.”.

b) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Listat për marrjen e kredive, brenda numrit të përcaktuar nga Kryeministri, miratohen nga sekretarët e përgjithshëm të ministrive/institucioneve përkatëse, ndërsa për institucionet në organikat e të cilave nuk ka funksion të sekretarit të përgjithshëm miratohen nga titullari i institucionit dhe më pas dërgohen në bankën e përzgjedhur, e cila është e detyruar të respektojë renditjen e përcaktuar në këto lista.”.

c) Pika 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“14.Fondi i përcaktuar për këtë qëllim të planifikohet në buxhetin përkatës vjetor të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe numri i kredive të dhëna të jetë nga 150 deri në 200 në vit.”.

2.Ngarkohen ministrat dhe drejtuesit e institucioneve qendrore të pavarura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha